

KOMISIONI I PËRBASHKËT I SHQIPËRISË DHE I KOSOVËS
PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE PËR DIASPORËN


VENDIM

Nr. 5, datë 22.11.2023

PËR

MIRATIMIN E “KALENDARIT TË PUNËS PËR SHPALLJEN
E KONKURSIT PËR TEKSTET MËSIMORE PËR MËSIMIN
E GJUHËS SHQIPE DHE KULTURËS SHQIPTARE NË DIASPORË
DHE NË MËRGATË ME TITULLIN “GJUHA SHQIPE
DHE KULTURA SHQIPTARE”, NIVELI III

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe i Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën (në vijim Komisioni i Përbashkët), i krijuar në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, “Për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë”, datë 23.03.2015, e lidhur në Tiranë, ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të Republikës së Shqipërisë, Ministrisë së Diasporës të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës, bazuar në Vendimin nr. 756, datë 23.09.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Komisionit të Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën”, Vendimin nr. 2-1151, datë 7.07.2020, “Për emërimin e grupit të punës”, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, Urdhrin nr. 686, datë 15.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për caktimin e përfaqësuesve të ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe botimit për diasporën në Komisionin e Përbashkët të Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore të Përbashkëta për Diasporën” dhe Urdhrin/Vendimin e Përbashkët, nr. 21, datë 13.01.2023, “Për miratimin e paketës së dokumenteve për procedurën e zhvillimit të konkursit të teksteve mësimore për diasporën, niveli II dhe niveli III”.



V E N D O S I :

Miratimin e kalendarit të punës për shpalljen e konkursit për tekstet mësimore për mësimin e gjuhës shqipe dhe kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë me titullin “Gjuha shqipe dhe kultura shqiptare”, niveli III, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Shtojca nr. 1

Nr.	Aktivitetet	Akti i miratimit	Afati kohor	Vendi
1.	Përgatitja dhe shpallja e konkursit për tekstet mësimore për diasporën në faqet ueb të dy ministrive përkatëse	Vendim i Komisionit të Përbashkët	janar 2024	online
2.				
3.	Shpallja e thirrjes për aplikim të recensentëve		shtator 2024	Faqe ueb Prishtinë -Tiranë
4.	Shqyrtimi dhe përzgjedhja e listës fituese të recensentëve dhe informimi i tyre	Vendim i Komisionit të Përbashkët për miratimin e listës së recensentëve për vlerësimin e tekstit mësimor të përbashkët për diasporën	tetor 2024	Prishtinë
5.	Pranimi i dorëshkrimeve të subjekteve konkurruese dhe kodimi i tyre	Procesverbal i Komisionit të Përbashkët	tetor 2024	Prishtinë – Tiranë
6.	Trajnimi i recensentëve nga Komisioni		tetor 2024	Online
7.	Dërgimi i dorëshkrimeve dhe standardeve me email te recensentët nga Sekretaria		tetor 2024	Online
8.	Pranimi i dorëshkrimeve të koduara nga Komisionit të Përbashkët, renditja e tyre, hapja e zarfit të dyllosur, si dhe shpallja e fituesit para subjekteve konkurruese	Procesverbal	nëntor 2024	Tiranë
9.	Miratimi i listës së dorëshkrimeve të teksteve të renditura sipas vlerësimeve dhe propozimi për ministrat	Vendim i Komisionit të Përbashkët	nëntor 2024	
10.	Miratimi i tekstit mësimor fitues nga ministrat	Urdhër/Vendim i përbashkët i ministrave përgjegjës për arsimin	dhjetor 2024	Prishtinë – Tiranë

KOMISIONI I PËRBASHKËT

Znj. Anila Ferizaj

Z. Arbër Salihi

Znj. Feime Llapashtica Lipscomb

Znj. Erida Koleci

Znj. Ardjana Gjini

Znj. Shqipe Gashi-Ramadani

Z. Isni Kryeziu

Znj. Mimoza Hysa Çuliqi

Znj. Evis Mastori